

Tirane me 16.04.2019

## KONTRATË

*Shitblerje Kuotash të Shoqërisë " Clover" Sh.p.k., NUIS :L82212021T*

Sot më datë \_16\_.04\_.2019 (dymije e nenetmbedhete), ne te nenshkruarit , **Massimo Piazzalunga** ortak i vetem i shoqërisë " *Clover " Sh.p.k., NUIS: L82212021T* , si dhe znj.Elisabeta Gjebrea me Z. Ardit Osmeni , ne perputhje me dispozitat e ligjit nr 9901 date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar, Kodit civil si dhe legjislacionit në fuqi, rame dakort per hartimin dhe nenshkrimin e kesaj kontrate Shitblerje Kuotash si me poshte vijon:

**Z. Massimo Piazzalunga**, shtetas Italian, lindur ne Romë( Itali) më 06/05/1958 dhe banues ne Macedonia në adresën Naroden Front 9/13 Skopje MK, mbajtës i pasaportës me nr. AA3328513, zoterues i 1 (nje) kuote te kapitalit të shoqërisë me vlere 100 000 (njqinde mije) lek ,

referuar më poshtë si Shitësit.

Znj. **Elisabeta Gjebrea** shtetes shqiptare lindur me 20/02/1978 , ne Lushnje , dhe banuese ne Tirane, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar , identifikuar nga pasaporta me nr 027921514 ,

**Z. Ardit Osmëni** , lindur me dt . 02/07/1989 , ne Tepelenë , dhe banues ne Tiranë, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga Karta e Identitetit Nr. 032449511

referuar më poshtë si Blerësi,

hartojmë këtë kontratë shitblerje kuotash me nenet e mëposhtme;

Neni 1

Objekti

Objekt i kësaj kontrate eshte shitblerja e kuotave te zotëruara nga shitësi tek bleresi, kuota të cilat përbëjnë 100(njqind) % të kapitalit të shoqërisë " *Clover " Sh.p.k., NUIS L82212021T* , që i korrespondon një sasi prej 100 pjesesh, me vlere nominale 1000 lek/pjese, dhe ku vlere totale e kapitalit te shoqerise eshte 100.000 (njëqind mije) Lek.

Ortaku i shoqërisë z. **Massimo Piazzalunga**, i shetë 100 % të kapitalit të tij me një vlerë prej 100000 (Njëqind mijë) lek, të blerësi .

Neni 2

Çmimi

Shitësi i shetë Blerësve të gjitha kuotat që ai ka në dorezim , të ndara përketesisht sipas ortakëve dhe çmimit si me poshtë;

**Massimo Piazzalunga shetë kuotën e tij të ndarë në 100 (një qinde) pjesë, me çmimin 100000 lek/pjesë , të cilat në total përbëjnë 100 pjesë me çmimin 100000 (Njëqind mijë) mijë Lek.**

Çmimi total i vlerës së kontratës është i barabartë me 100000 ( Njëqind mijë) lek.

Neni 3

Mënyra e pagesës

Palët janë likuiduar paraprakisht për vlerën totale të kuotave të shitura me vlerë 100000 ( Njëqind mijë) mijë lek dhe nuk kanë pretendime lidhur me këtë fakt.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Nga nënshkrimi i kësaj kontrate Shitësit humbasin të drejtën e pronësisë mbi kuotat në zotërim, pronësi të cilën e fitoj Blerësit i cili shndërrohet në ortak me kuota të ndarë përketesisht në 50(Pesë dhjetë) për qinde (%) me vlerë nominale 5000 ( pesë mijë) lek/pjesë, dhe me vlerë totale 50000 (pesëdhjetë)mijë lekë të cilat kalojnë në pronësi të Znj Elisabeta Gjebrea 50(Pesë dhjetë) për qinde (%) me vlerë nominale 5000 ( pesë mijë) lek/pjesë, dhe me vlerë totale 50000 (pesëdhjetë)mijë lekë të cilat kalojnë në pronësi të Z. Ardit Osmeni

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate ,pala blerëse është pronare e vetme të kuotave të kësaj shoqërie.

Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë në bazë të legjislacionit në fuqi nga titulli i pronësisë mbi kuotat objekt shitblerjeje, që nga nënshkrimi i kësaj kontrate i kalojnë Blerësit.

Shitësi dhe blerësi bien dakort që pas nënshkrimit të kësaj kontrate të gjitha të drejtat dhe detyrimet tregtare, tatimore, dhe të tjera të ngjashme, të cilat kanë lindur mbi

shoqërinë Clover dhe ato që do të lindin më vonë, të bien mbi blerësin, në kushtet kur ky i fundit do të jetë pronari dhe ortak i shoqërisë.

Neni 5  
Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët pjesëmarrëse.

Neni 6  
Të ndryshme

Palët zotohen se do të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me këtë kontratë në të kundërt kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo kontratë iu lexua palëve me zë të lartë. Ato pasi e kuptuan përmbajtjen e saj, e nënshkruan me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë. Kjo kontratë hartohet në 3 kopje origjinale me fuqi të njëjtë juridike. Një kopje e kesaj kontrate do te depozitohet ne Qendren Kombetare te Regjistrimit per te bere te mundur regjistrimin e kalimit te kuotave, dhe kopjet e tjera do te mbahen perkatesisht nga nje e tille prej blerësit dhe shitësit.

Sa me siper nenshkruajme kete kontrate me mirekuptim te plote dhe me vullnet te lire.

Shitësi

Massimo Piazzalunga



Blerësi

Ardit Osmëni

Elisabeta Gjebra